



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3021/5 prot.,

Datë 07.11.2025

V E N D I M

Nr. 1619/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.11.2025 me:

Objekt:

Modifikimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit, “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65227-10-15-2025, me objekt: “*Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendorsje)*”, me fond limit 154,687,373.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Shendelli” SHPK me NIPT K07924803N, me adresë: Lagjja Kastrioti ,rruga Andon Profka ,2 kullat Fier.

Operatori ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK me NIPT L79326502O, me adresë: Rruga Kosovareve, Rruga Ndreko Rino, Pallatet Viridario, Hyrja 1, Kati 3, Ap 35.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Vlore.
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Vlore, 9400.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë ankimuar në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “NG STRUCTURES” SHPK ka respektuar afatet ligjore, por nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, konkretisht nuk permban nje nga elementet e cituara ne ligj sic eshte mandat pagesa e cila nuk eshte paraqitur. Ankimuesi “Shendelli” SHPK, gjithashtu ka respektuar afatet ligjore dhe kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 31.10.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-65227-10-15-2025, me objekt: “*Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendosje)*”, me fond limit 154,687,373.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6005, datë 24.10.2025 dhe me nr. 3021/2025 prot, datë 27.10.2025 i operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK, mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit.

II.2.1. Bazuar në nenin 112, pika 2 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.3. Në datën 24.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6011, datë 24.10.2025 dhe me numër protokolli nr. 3027/2025 prot., datë 27.10.2025, e operatorit ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3.1 Bazuar në piken 2 të nenit 112, të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Me anë të shkresës nr.16406/8 prot., datë 31.10.2025, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.3027/1 prot., datë 03.11.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë, ka dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik informacionin mbi trajtimin e ankesës nr. 3027 prot., datë 27.10.2025 të operatorit ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK. Gjithashtu me po të njëjtën përmbajtje është përcjellë nëpërmjet postës shkrese me nr.16406/7 datë 30.10.2025, protokolluar me tonën 3027/4 datë 06.11.2025. Referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin duke mos e marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK, pasi nuk ka plotësuar elementët e pagesës (së bashku me kopje hardëare të postës elektronike drejtuar operatorit ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK), si më poshtë vijon:

[...]

Autoriteti Kontraktor pasi u njohëm me ankesën e depozituar nga Operatori Ekonomik, ka konstatuar nga verifikimet në Sistemin Elektronike të Ankesave, operatori ekonomik NG

STRUCTURES sh.p.k nuk plotëson të gjithë elementët e ankesës, pasi pagesa e tarifës rezulton me status të Pa Paraqitur.

Operatori ekonomik është njoftuar me anën e postës elektronike më datë 29.10.2025 në orën 09:50 lidhur me detyrimin për pagesën e tarifës për llogari të buxhetit të shtetit.

Gjithashtu i është bërë me dije se nëse ankesa nuk korrigjohet brenda dy ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paraqitur.

Nga verifikimi në sistem ankesa vazhdon të ketë statusin e pagesës Pa Paraqitur.”

II.5. Me qëllim verifikimin e mëtejshëm në lidhje me pagesën e tarifës financiare, KPP iu drejtua me kërkesën nr.3027/2, datë 05.11.2025, Drejtorisë së Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë KPP, për informacion mbi pagesën e tarifës financiare të kryer nga operatori ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Me kthimin e përgjigjes me nr.3027/3 prot., datë 06.11.2025 Drejtoria e Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës informon se:

“Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 3027/2 prot., datë 05.11.2025, me lëndë: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr.3027/2025 prot., datë 27.10.2025 me numër ankimi elektronik A/2025/6011, Operatori ekonomik "NG STRUCTURES" Shpk nuk ka paraqitur dokument bankar, që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifën e ankimimit.

Referuar raportit datë 04.11.2025 të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera për muajin Tetor 2025, rezulton se Operatori Ekonomik "NG STRUCTURES" Shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”

II.7. Me anë të shkresës nr.16406/7 prot., datë 30.10.2025, protokolluar prane Komisionit të Prokurimit Publik me nr.3021/1 prot., datë 31.10.2025 autortieti kontraktor Bashkia Vlore, ka dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik informacion mbi trajtimin e ankesës nr. 3021 prot., datë 27.10.2025 të operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK. Gjithashtu me po të njëjtën përmbajtje është përcjellë nëpërmjet postës shpresa me nr.16406/7 datë 30.10.2025, protokolluar me tonën 3021/2 datë 06.11.2025. Referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK, si më poshtë vijon:

“[...]Për sa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për klasifikimin e Kontrates "Mallra", sqarojmë:

Klasifikimi i një procedure prokurimi, sipas Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", bëhet në bazë të objektit kryesor të kontratës, duke u orientuar nga natyra ekonomike e saj dhe pjesa me vlerën më të madhe në preventivin përkatës.

Këtë e përcakton qartë neni 5, pika 1 dhe 2 i ligjit, ku thuhet se: "Kontratat që kanë si objekt të tyre dy ose më shumë lloje prokurimi për punë, shërbime ose furnizime, jepen në përputhje

me dispozitat e zbatueshme, sipas llojit të prokurimit që karakterizon objek- tin kryesor të kontratës në fjalë... Objekti kryesor përcaktohet në përputhje me vlerën më të lartë të parashikuar për shërbimet ose furnizimet përkatëse."

Në preventivin e miratuar për këtë objekt, rezulton se: rreth 2/3 e vlerës totale i përkasin pajisjeve dhe rreth 1/3 e vlerës përfshin punime ndërtimi ndihmëse.

Pra, pjesa më e madhe ekonomike dhe që përcakton qëllimin kryesor të investimit është furnizimi dhe vënia në punë e pompave të reja, ndërsa punimet ndërtimore kanë rol ndihmës dhe jo karakter parësor.

Pretendimi i operatorit ekonomik nuk pranohet.

2. Vendosja e kriterëve të pajustificuara për personel teknik

Ne dokumentet e tenderit janë kërkuar në mënyrë të pazakonte për një kontratë "mallrash":

nente (9) inxhinierë të profilizuar në fusha të ndryshme. ?

? njezet e një (21) specialiste dhe staf profesional.

? dyzet (40) punetore të kualifikuara,

shoqeruar me një listë të gjere mjeteve dhe pajisjesh ndërtimore.

Ky volum kërkesash tregon qartë se objekti nuk është furnizim mallrash, por punime ndërtimore.

AK në përgjigjen e kërkesës për sqarim është shprehur se "numri i kërkuar i punonjësve dhe stafit teknik është përcaktuar në bazë të grafikut të punimeve, zërimit të zerave të preventivit dhe afatit të punimeve, duke rezultuar në total 31,723 ore pune që justifikojnë kërkesën për 40 punonjës, përfshirë stafin teknik".

Por kjo nuk qëndron sepse, ky argument bie ndesh me vetë klasifikimin e procedurës si 'furnizim mallrash'. Një kontratë që parashikon grafik punimesh, ore pune, fuqi punetore, staf teknik të profilizuar dhe mjete ndërtimi, nuk mund të konsiderohet kontratë për furnizim, por kontratë për punime në kuptimin e ligjit.

Për më tepër, vendosja e një numri të fiksuar dhe të lartë punonjësish (40) nuk është mbështetur në asnjë analizë të detajuar proporcionaliteti midis volumit të punimeve dhe afatit kohor. Një kërkesë e tillë shkon përtej qëllimit të ligjit, duke kufizuar pjesëmarrjen dhe krijuar barre të panevojshme mbi operatorët ekonomikë.

Për sa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për personelin teknik, sqarojmë:

Lidhur me pikën 2. të ankesës, Autoriteti Kontraktor sqaron se kërkesat për numrin dhe profilin e personelit teknik janë vendosur me qëllim të garantimit të cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit në zbatimin e kontratës, edhe pse kjo është klasifikuar si kontratë furnizimi mallrash.

janë përcaktuar në bazë të volumit të furnizimit, kompleksitetit teknik të pajisjeve dhe nevojës për instalim dhe komisionim të sigurt. siguron që punimet e montimit, instalimit dhe testimit të pajisjeve të kryhen sipas standardeve teknike, minimizon rrezikun e vonësve ose ndërprerjes së operimit të hidrovorit, garanton përdorimin e pajisjeve ndërtimore dhe instrumenteve teknike me standard të lartë sigurie.

Autoriteti Kontraktor thekson se numri i punonjësve nuk është i fiksuar në mënyrë arbitrare, por është nxjerrë nga analiza e nevojave operative, grafiku i punimeve dhe vlerësimi i orëve të punës, për të siguruar përfundimin e kontratës brenda afatit të përcaktuar dhe në përputhje me standardet e sigurisë dhe cilësisë.

Kjo dispozitë është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 "Për pro- kurimin publik" dhe nenin 40, pika 6, të VKM nr. 285/2021, të cilat lejojnë Autoritetin Kontraktor të përcaktojë kërkesa për aftësi teknike dhe profesionale në funksion të gar- antimit të zbatimit të kontratës me cilësi të lartë.

Në këtë kontekst, kriteret e vendosura janë objektive, proporcionale dhe të justifikuara teknikisht, duke mos kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që mund të plotësojnë kërkesat në mënyrë efektive dhe të sigurt.

3. Kërkesa për certifikime elektrike të paarsyetuara dhe të pambeshtetura ligjrisht. Në dokumentet e tenderit janë kërkuar disa profile specifike:

? Inxhinier Elektrik i certifikuar për monitorimin e gazit dhe vajit të transformatoreve.

? Inxhinier i certifikuar për kamera termografike.

? Inxhinier me certifikate për SCADA/PLC, etj.

Keto kërkesa janë pa reference në standarde ndërkombëtare (IEC/ISO), nuk është argumentuar domosdoshmëria e tyre dhe nuk është përcaktuar asnjë trup certifikues i akredituar nga DPA që mund të leshojë certifikatat përkatëse.

Gjithashtu, kërkesa që këta specialistë të jenë në listepagesë 3 muajt e fundit është diskriminuese dhe pa baze ligjore.

Për sa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për certifikime elektrike, sqarojmë:

Në lidhje me pikën 2.3.6 të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST) - "Kërkesat për personel teknik të certifikuar",

Autoriteti Kontraktor sqaron se këto kërkesa janë vendosur me qëllim të garantimit të sigurisë teknike, cilësisë së zbatimit dhe funksionimit afatgjatë të hidrovorit, si objekt me rëndësi të veçantë për mbrojtjen nga përmbytjet dhe infrastrukturën kritike të zonës.

Kërkesat për inxhinierë të certifikuar në fushat e transformatorëve, termografisë dhe sistemeve automatike SCADA/PLC nuk janë të panevojshme apo diskriminuese, por janë drejtëpërdrejt të lidhura me kompleksitetin teknik të pajisjeve që do të furnizohen, instalohen dhe vihen në funksion në kuadër të kësaj kontrate.

Këto certifikime janë të domosdoshme për të garantuar që:

instalimi dhe komisionimi i sistemeve elektrike dhe automatike të kryhen në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë elektrike;

të parandalohet çdo rrezik i ndërprerjes së punës apo dëmtimit të transformatorëve, pompave dhe sistemeve të komandimit;

të sigurohet që investimi publik të jetë i qëndrueshëm, funksional dhe i sigurt në operim afatgjatë.

Autoriteti Kontraktor thekson se kërkesat për certifikatat përkatëse nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht tre inxhinierë të ndryshëm. Një ose disa inxhinierë mund të plotësojnë më shumë se një nga certifikimet e kërkuara, për sa kohë që dokumentohet zotërimi i tyre sipas kërkesave të DST-së.

Kjo dispozitë është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 6, të VKM nr. 285/2021, të cilat i japin Autoritetit Kontraktor të drejtën të përcaktojë kërkesa për aftësi teknike dhe profesion-ale në funksion të garantimit të cilësisë së zbatimit të kontratës.

Pretendimi i operatorit ekonomik nuk pranohet.

4. Kërkesa të pajustificuara për saldatore dhe certifikime teknike të pamundura në Shqipëri. Në dokumente është kërkuar:

? "Saldator me TIG" dhe

? "2 saldatore te certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1:2017".

Sipas verifikimit ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit (DPA), ne Shqiperi nuk ekziston asnje trup certifikues i akredituar per kete standard. Prandaj, kerkesa eshte teknikisht e pambeshtetur dhe ligjerisht e pazbatueshme.

Për sa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik për lidhur me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për Saldator me Tig dhe 2 Saldator te certifikuar sipas standartit EN ISO 9606-:2017, sqarojmë:

Procesi TIG/GTAË (ISO 4063 kodi 141) përdoret kur kërkohet cilësi e lartë saldimi për çelik karbon/inoX, tubacione të holla, elementë të precizionit në stacione pompimi. Kërkesa është teknikisht e domosdoshme.

"Saldator me TIG" nuk është "pajisje", por profil pune me aftësi për TIG.

Kërkesa për 2 saldatorë të certifikuar EN ISO 9606-1:2017 është standard europian për kualifikimin e saldatorëve në çelik.

Pranohet çdo certifikatë ekuivalente e lëshuar nga trupa të akredituar në rrjetin

Provat NDT në saldimet me UT sipas ISO 17640 dhe nivele pranimi ISO 11666 janë praktikë e zakonshme për integritet strukturor.

Pse EN ISO 9606-1:2017: Ky është standardi europian i kualifikimit të saldatorëve për saldimet me shkrirje në çelika. Kërkesa për 2 saldatorë të certifikuar siguron integritet në nyjet kritike (lidhje tubacionesh, struktura mbajtëse, suportet e pajisjeve).

"Nuk ka trup të akredituar në Shqipëri" nuk është argument ligjor: Edhe nëse sot një trup vendas nuk mbulon konkretisht 9606-1, certifikatat e lëshuara nga trupa të akredituar në vende të BE/EEA njihen përmes EA-MLA. DPA është EA-MLA signatory dhe njohja e ndërsjellë është e sanksionuar. Për më tepër, certifikimi i personelit kryhet sipas ISO/IEC 17024 dhe NDT sipas ISO 9712 kur aplikohet.

Kërkesat për TIG dhe EN ISO 9606-1 janë plotësisht të mbështetura nga standardet europiane dhe mekanizmat e akreditimit.

Pretendimi i operatorit ekonomik nuk pranohet.

5. Mjete te kerkuara pa baze teknike dhe jashte objektit te punimeve

Emri i mjetit Sasi Njesi Statusi

Aparat Argoni 1 cope Ne pronesi ose me qera

*Ponton (drage lundruese) Automjet teknologjik e pajisur me pompe vakumi per thithje llumi.
1 cope Ne pronesi ose me qera 1 cope Ne*

Pajisje me ultratinguj per detektimin e defekteve per provat pa shkaterrim te saldimeve per 1

strukturat metalike per trashesi deri ne 60mm

cope Ne pronesi ose me qera

Mates Tokezimime certifikate kalibrimi 1

cope Ne pronesi ose me qera

Multimeter Digital me certifikate kalibrimi

cope Ne pronesi ose me qera

Dare multimeter me certifikate kalibrimi 1

Ne pronesi ose me qera

cope Termike 1 cope Ne pronesi ose me qera

Kamera 1 cope Ne pronesi ose me qera

Kalibrues 4-20mA

Aparate Saldimi me inverter, me certifikate kalibrimi, per saldim me elektrode dhe TIG 410 A

1 cope Ne pronesi ose me qera

*Aparate Sladimi me inverter, me certifikate kalibrimi, per saldim me elektrode dhe
MIG/MAG 500*

cope Ne pronesi ose me qera

Për sa më sipër, referuar pretendimit të operatorit ekonomik për lidhur me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për mjetet e kerkuara, sqarojmë:

Ne kuader te programit te punimeve te mirembajtjes dhe rehabilitimit te Hidrovorit te Vlores, objekt qe sherben per largimin e ujerave nga kanalet e kullimit te qytetit me qellim largimin e rriskut te permbytjes se qytetit ne raste shirash, eshte parashikuar nderhyrja edhe ne pjesen dalese te hidrovorit, ku jane evidentuar depozitime te konsid- erueshme llumi dhe materiale sedimentare, te cilat pengojne qarkullimin normal te ujit dhe ulin ndjeshem kapacitetin hidraulik te kanalit.

Keto depozitime kane ardhur si rezultat i rrjedhjeve me ngarkese te larte sedimentesh, veçanerisht gjate periudhave me reshje intensive, si dhe per shkak te mungeses se pastrimeve periodike ne kete seksion. Per pasoje, eshte e domosdoshme kryerja e punimeve te thellimit te shtratit dhe formimit te skarpateve, ne menyre qe dalja e ujit nga hidrovorit te rikthehet ne parametrat e projektuar.

1.Në kuadër të projektit të rikonstruksionit të hidrovorit, përdorimi i aparatit të argonit për saldimin me metodën TIG është i domosdoshëm për arritjen e cilësisë së lartë të punimeve. Kjo pajisje siguron:

Saldim me precizion të lartë, i nevojshëm për lidhjet metalike në strukturat hidraulike ku kërkohet rezistencë dhe qëndrueshmëri maksimale.

Mbrojtje nga oksidimi dhe defektet gjatë procesit të saldimit, duke përdorur gazin inert argon për të shmangur dëmtimet në metal.

Përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të cilësisë, të cilat janë të domosdoshme për sigurinë dhe funksionalitetin e strukturave hidraulike.

Për këto arsye, aparati i argonit është një mjet thelbësor për realizimin e punimeve me cilësi të lartë dhe që plotëson kërkesat teknike dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së hidrovorit.

2. Pershkrimi i punimeve dhe nevoja per mjetin "Drage Lundruese"

Punimet qe do te kryhen perfshijne:

Pastrimin dhe heqjen e shtreses se llumit nga fundi i kanalit dales;

Thellimin e shtratit te kanalit sipas nivelit te projektuar;

Formimin dhe sistemimin e skarpateve ne te dy anet e kanalit;

Transportimin dhe depozitimin e llumit te nxjerre ne zonen e percaktuar.

Zona e nderhyrjes ndodhet nen nivelin e ujit dhe ka thellesi qe varion ndermjet 1.2 deri ne 4.5 metra, me terren te bute dhe me shtrese te trashe sedimentesh. Ne keto kushte, perdorimi i mjeteve tokesore (ekskavator, fadrome, etj.) eshte teknikisht i pamundur, pasi mjetet nuk mund te operojne mbi terren te paqendrueshem dhe te mbuluar nga ujerat.

Per kete arsye eshte zgjedhur mjeti "Drage Lundruese", nje pajisje e lundrueshme e specializuar per pastrimin e kanaleve dhe baseneve ujore, e cila punon direkt mbi siperfaqen e ujit dhe realizon germimin nepermjet nje pompe thithese me sistem preres dhe transportues (tubacioni i shkarkimit).

Parimi i funksionimit dhe karakteristikat teknike te Drages Lundruese

Draga lundruese eshte nje mjet mekanik me strukture pontoni qe qendron mbi uje dhe eshte e pajisur me:

Sistem thithes (pompa hidraulike) per marrjen e llumit dhe sedimenteve nga fundi i kanalit.

Sistem preres ose cutter head, i cili sherben per zbutjen e materialit para thithjes;

Tubacion fleksibel shkarkimi, permes te cilit materiali i nxjerre transportohet deri ne vendin e depozitimit;

Sisteme ankorimi dhe levizjeje (ëinches, kablllo, spiranca) qe mundesojne manovrimin me precizion ne siperfaqe.

Ne baze te karakteristikave te mjetit, kapaciteti i pastrimit varion ndermjet 80-150 m³/ore, ne varesi te konsistences se materialit dhe distances se shkarkimit.

Thellesia e punes se drages mund te arrije deri ne 6 metra, gje qe e ben te pershtatshme per punime ne seksione te thella dhe me akses te veshtire.

Avantazhet teknike te perdorimit te Drages Lundruese

Perdorimi i ketij mjeti eshte zgjidhja me efikase dhe e sigurt per kete lloj nderhyrjeje, per arsye si me poshte:

Pershtatje me kushtet hidraulike: Mjeti operon mbi uje pa qene nevoja te thahet kanali apo te mbyllet dalja e hidrovorit.

Mbrojtje e strukturave ekzistuese: Fale saktetise se sistemit te ger- mimit, shmanget demtimi i skarpateve ekzistuese, argjinaturave dhe ele- menteve te betonuar.

Prodhimtari e larte dhe kohezgjatje e shkurter e punimeve: Mundeson heqjen e sasive te medha te llumit ne kohe me te shkurter krahasuar me metodat tradicionale.

Ndikim minimal mjedisor: Pasi mjeti qendron mbi uje, nuk shkakton tur- bullira te medha, nuk shkaterron bimesine e skarpateve dhe nuk ndikon ne stabilitetin e brigjeve.

Siguri ne punime: Perdorimi i pajisjes lundruese redukton rrezikun e fun- dosjes se mjeteve te renda dhe demtimeve gjate punes ne terren te lagesht.

Metodologjia e punimeve

Punimet do te realizohen sipas nje metodologjie te detajuar si me poshte:

Percaktimi i seksioneve te punes ne baze te projektit dhe matjeve topo- grafike ekzistuese;

Vendosja e drages ne pozicion pune dhe ankorimi i saj me kabllo ne te dy anet e kanalit;

Pastrimi progresiv i llumit, duke levizur ne menyre te kontrolluar nga njera ane e kanalit ne tjetren;

Formimi i skarpateve sipas pjerresise se parashikuar ne projekt;

Transportimi i materialit te nxjerre nepermjet tubacionit te shkarkimit drejt zones se depozitimit te miratuar;

Kontrolli topografik dhe teknik pas çdo segmenti per te garantuar thelles- ine dhe formen e kerkuar te seksionit;

Pastrim perfundimtar dhe rregullim i siperfaqes ujore per te rikthyer rrjedhjen e lire dhe funksionimin normal te kanalit dales.

Aspektet e sigurise dhe mjedisit

Gjate kryerjes se punimeve do te respektohen te gjitha masat e sigurise ne pune dhe rregulloret mjedisore ne fuqi.

Personeli qe operon dragen eshte i certifikuar dhe me eksperience, ndersa zona e puni- meve do te sinjalizohet per te shmangur qarkullimin e mjeteve te tjera ujore. Materiali i nxjerre (llum dhe sedimente) do te depozitohet ne vendin e percaktuar nga autoritetet perkatese, me kujdes qe te mos shkaktoje ndotje apo perhapje ne zona bujqesore ose ne rrjedhje dytesore.

Gjithashtu, gjate procesit te pastrimit do te monitorohen:

Parametrat hidrologjike te daljes se ujit nga hidrovorit.

Turbullira dhe ngarkesa sedimentare ne uje, per te shmangur ndotjen poshte rrjedhes. Stabiliteti i skarpateve dhe çdo levizje e mundshme gjate procesit te pastrimit.

Bazuar ne analizen teknike dhe kushtet ekzistuese ne terren, perdorimi i mjetit Drage Lundruese eshte zgjidhja me e pershtatshme, efikase dhe e sigurt per kryerjen e puni- meve te pastrimit te llumrave ne pjesen dalese te hidrovorit.

Kjo metode garanton:

Thellim te qendrueshem dhe te kontrolluar te shtratit;

Formim te sakte te skarpateve;

Rikthim te kapacitetit hidraulik te kanalit;

Ndikim minimal ne mjedis dhe infrastrukture

Gjithashtu per sa i perket punimeve elektrike dhe ato elektromekanike te parashikuara ne kete projekt, eshte e domosdoshme kryerja e kontroleve teknike dhe testimeve te cilesise se materialeve dhe bashkimeve te salduara, ne perputhje me standardet nderkombetare per siguri dhe qendrueshmeri strukture.

Per realizimin e ketyre verifikimeve, subjekti zbatues do te perdore pajisje te specializuara, te certifikuara dhe me dokumentacion te vlefshem kalibrimi.

3. Automjet teknologjik i pajisur me pompe vakumi per thithje llumi.

Ky automjet teknologjik me pompë vakumi është i domosdoshëm për pastrimin efikas, të sigurt dhe të kontrolluar të llumit dhe ujërave të zeza, në përputhje me kërkesat teknike të projektit. Ky Automjet garanton:

Sigurimin e një mjedisi të pastër dhe të sigurt për punimet e mëtejshme, duke shmangur depozita që mund të dëmtojnë sistemin hidraulik.

Efikasitetin në largimin e materialeve lëngëshe në mënyrë të shpejtë dhe të kontrolluar, duke zvogëluar kohën e ndërtimit dhe rrezikun për personelin.

Parandalimin e ndotjes dhe dëmtimeve mjedisore, duke transportuar llumin në vendet e autorizuarra për trajtim.

Për këto arsye, përdorimi i një automjeti të tillë është i domosdoshëm për zbatimin e projektit sipas standardeve të sigurisë, higjienës dhe cilësisë.

4. Pajisje me ultratinguj për detektimin e defekteve në saltime (NDT për struktura metalike deri në trashësi 60 mm).

Pajisja me ultratinguj (Ultrasonic Flaw Detector) përdoret për të kryer prova pa shkatërrim (Non-Destructive Testing - NDT) në saltime dhe materiale metalike, me qëllim zbulimin e defekteve të brendshme si porozitete, krisje, përfshirje të huaja, ose mungese bashkimi në qepjet e saldimit.

Pajisja dërgon vlera ultrasonike përmes materialit. Reflektimet e këtyre vlerave nga papërsosmëritë e brendshme regjistrohen dhe interpretohen në ekran, duke mundësuar identifikimin e defekteve në mënyrë të saktë dhe pa demtuar strukturën.

Përdoret për:

Struktura metalike me trashësi deri në 60 mm;

Kontroll i qepjeve të salduara në profile çeliku, tubacione ose elemente mbajtës; Kontroll cilësor sipas EN ISO 17640, EN ISO 11666, ose standardeve ekuivalente ASME.

Ky test siguron cilësi dhe integritet të plote strukturor, garanton jetegjatesinë e elementeve metalike dhe shmang defektet që mund të komprometojnë sigurinë në punime hidroteknike dhe strukturore.

5. Mates togezimi (Torque Meter) me certifikatë kalibrimi

Matesi i togezimit përdoret për të kontrolluar momentin e shtrengimit të bulonave, vidave dhe elementeve lidhës në strukturat metalike, për të siguruar që ato janë të shtrenguara sipas specifikimeve të projektit dhe standardeve teknike.

Pajisja mat forcën rrotulluese (momentin) të aplikuar në boshtin e mjetit, e shprehur në N·m (Neëton-metra).

Kalibrimi i pajisjes garantohej me certifikatë kalibrimi të vlefshme, që siguron saktësi dhe gjurmueshmeri sipas ISO 6789.

Përdoret për:

Bulonat dhe lidhjet ne strukturat metalike te hidrovorit, tubave te pompave dhe platformave;

Montimet e elementeve ndihmes te hidrovorit (mbajtese, trare, platforma met- alike, etj.).

Matja e togezimit eshte kritike per te shmangur si shtrengimin e tepert (qe shkakton deformime ose thyerje), ashtu edhe shtrengimin e pamjaftueshem, qe mund te ule stabilitetin e lidhjes strukturore.

6. Multimeter digital me certificate kalibrimi

Multimetri dixhital perdoret per kontrollin elektrik te qarqeve, matjen e tensionit, rrymes dhe rezistences ne instalimet ndihmese te sistemit te pompimit, sensoreve, motoreve dhe paneleve elektrike te hidrovorit.

Pajisja perfshin qark elektronik me konvertues analog-dixhital, qe jep lexime te sakta ne ekran LCD. Kalibrimi periodik siguron sakte si sipas IEC 61010-1 dhe IEC 61326-2-2.

Kontrolli i vazhdimetise elektrike;

Matja e tensioneve DC/AC ne panele;

Verifikimi i sinjaleve nga sensoret dhe instrumentet e matjes ne terren.

Garanton funksionim te sigurt dhe efikas te pajisjeve elektrike, parandalon defektet dhe mundeson mirembajtje korrekte gjate dhe pas punimeve.

7. Dare multimeter (Clamp Meter) me certificate kalibrimi

Pajisja perdoret per matjen e rrymes elektrike ne qarqe operative pa nderprerje, permes parimit te induksionit magnetik.

Darja perqafon perqyesin elektrik dhe mat fushen magnetike te krijuar nga rryma qe kalon, duke e konvertuar ne vlere elektrike te lexueshme ne ekran. E kalibruar sipas IEC 61010-2-032 dhe me certif-

ikate validiteti. Perdoret per:

Matja e rrymes ne motore dhe linja furnizimi te pompave; Kontrolli i ngarkesave elektrike gjate testimeve funksionale.

Siguron verifikim te shpejte dhe te sigurt te qarkut elektrik, pa nevojë per nder- prerje te sistemit, duke ruajtur integritetin e pajisjeve.

8. Kamere termike

Kamera termike perdoret per identifikimin e zonave me mbinxehje, humbje termike ose kontakte te dobeta elektrike ne panele dhe motore, si dhe per kontrollin e zhurmave termike ne sistemet mekanike.

Pajisja detekton rrezatimin infra te kuq te emetuar nga siperfaqet dhe e paraqet ate ne forme imazhi termografik me shkalle ngjyrash qe perfaqeson temperaturen relative.

Perdoret per:

Kontroll i motoreve te hidrovorit dhe paneleve elektrike; Monitorim i elementeve strukture metalike per mbinxehje lokale ose rrjedhje termike.

Lejon identifikimin e parakohshem te defekteve qe nuk jane te dukshme me sy te lire, duke shmangur demtime te mevonshme dhe nderprerje ne funksionim.

9. Kalibrues 4-20 mA

Kalibruesi 4-20 mA perdoret per testimin, verifikimin dhe kalibrimin e instrumenteve te matjes dhe kontrollit, qe funksionojne me sinjal standard industrial 4-20 mA (sen- sore presioni, transmetues temperature, pozicionere valvulash, etj.).

Pajisja gjeneron ose lexon sinjalin elektrik 4-20 mA dhe e krahason me vlerat e references, duke mundesuar kalibrim te sakte te instrumenteve te fushes. Perdoret per:

Testimin e transmetuesve te presionit dhe nivelit ne sistemet hidraulike te hidro- vorit;

Kontrolli i instrumenteve te automatizimit dhe mbikeqyrjes se pompave.

Siguron qe te gjitha pajisjet e matjes dhe komandimit te japin sinjal te sakte dhe te besueshem, duke garantuar funksionim korrekt te sistemeve automatike.

10. Aparate Saldimi me inverter, me certificate kalibrimi, per saldim me elektrode dhe TIG 410 A.

Aparati i saldimit me inverter, i pajisur me certificate kalibrimi dhe i afte per saldim me elektrodë dhe TIG 410 A, eshte i domosdoshem per realizimin e punimeve me cilësi të lartë, siguri për strukturën dhe personelin, dhe përputhshmëri me kërkesat teknike të projektit.

Aparatet me inverter mundësojnë saldim të qëndrueshëm, të saktë dhe pa defekte në lidhjet metalike të strukturave hidraulike.

Mundësojnë saldim me elektrodë dhe TIG (up to 410 A), të nevojshme për punët specifike të rikonstruksionit të hidrovorit.

Aparatet me certifikatë kalibrimi sigurojnë që parametrat e saldimiit janë të saktë, duke parandaluar defekte strukturore dhe rreziqe për operatorët.

11.Aparate Sladimi me inverter, me certifikate kalibrimi, per saldim me elektrode dhe MIG/MAG 500 A.

Mundësojnë saldim me elektrodë dhe MIG/MAG deri në 500 A, duke përballuar trashësitë dhe llojet e ndryshme të metaleve të përdorura në projekt.

Aparatet me inverter janë më të lehta, të energjetikisht efikase dhe më të shpejta për përdorim krahasuar me aparatet tradicionale, duke rritur produktivitetin në terren.

Sa shpjeguar me siper perdorimi i ketyre mjeteve siguron cilesi te larte, saktesi matjesh dhe parandalim defektesh, duke garantuar perfundimin e punimeve sipas kerkesave te projektit dhe standardeve te ndertimit ne fuqi.

Pretendimi i operatorit ekonomik nuk pranohet.

Konkluzion:

Sa më sipër, referuar të gjitha pikave të ankesës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi refuzimin e ankesës, së paraqitur nga operatori ekonomik "SHENDELLI" sh.p.k."

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik elektronikisht me nr. A/2025/6011, datë 24.10.2025 dhe me nr. 3027 prot, datë 27.10.2025 e operatorit ekonomik "NG STRUCTURES" SHPK, për modifikimin e dokumentave të tenderit, për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me nr. REF-65227-10-15-2025, me objekt: "Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendosje)", me fond limit

154,687,373.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar me datë 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

*“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik. 2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, **pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse**, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.2. Ne lidhje me ankesën nr. A/2025/6011, datë 24.10.2025 dhe me nr. 3027 prot, datë 27.10.2025 e operatorit ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK, për modifikimin e dokumentave të tenderit, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65227-10-15-2025, me objekt: “Rikonstruktion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendorsje)”, me fond limit 154,687,373.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar me datë 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë, nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së mësipërme konstatohet, se formulari i ankesës së dorëzuar është me të meta, pasi mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

III.1.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/ skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”*

III.1.4. Me anë të shkresës nr.16406/8 prot., datë 31.10.2025, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.3027/1 prot., datë 03.11.2025 me anë të së cilës autortieti

kontraktor Bashkia Vlore, ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës nr. 3027 prot., datë 27.10.2025 të operatorit ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK. Referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin duke mos e marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK, pasi nuk ka plotësuar elementët e pagesës (së bashku me kopje hardëare të postës elektronike drejtuar operatorit ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK), si më poshtë vijon:

[...]

Autoriteti Kontraktor pasi u njohëm me ankesën e depozituar nga Operatori Ekonomik, ka konstatuar nga verifikimet në Sistemin Elektronike të Ankesave, operatori ekonomik NG STRUCTURES sh.p.k nuk plotëson të gjithë elementët e ankesës, pasi pagesa e tarifës rezulton me status të Pa Paraqitur.

Operatori ekonomik është njoftuar me anën e postës elektronike më datë 29.10.2025 në orën 09:50 lidhur me detyrimin për pagesën e tarifës për llogari të buxhetit të shtetit.

Gjithashtu i është bërë me dije se nëse ankesa nuk korrigjohet brenda dy ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

Nga verifikimi në sistem ankesa vazhdon të ketë statusin e pagesës Pa Paraqitur.”

II.1.5. Me qëllim verifikimin e mëtejshëm në lidhje me pagesën e tarifës financiare, KPP iu drejtua me kërkesën nr.3027/2, datë 05.11.2025, Drejtorisë së Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë KPP, për informacion mbi pagesën e tarifës financiare të kryer nga operatori ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.1.6. Me kthimin e përgjigjes me nr.3027/3 prot., datë 06.11.2025 Drejtoria e Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës informon se:

“Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 3027/2 prot., datë 05.11.2025, me lëndë: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr.3027/2025 prot., datë 27.10.2025 me numër ankimi elektronik A/2025/6011, Operatori ekonomik "NG STRUCTURES" Shpk nuk ka paraqitur dokument bankar, që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifën e ankimimit.

Referuar raportit datë 04.11.2025 të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera për muajin Tetor 2025, rezulton se Operatori Ekonomik "NG STRUCTURES" Shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”

III.1.7. Referuar pikës 2, të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3, të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve që të korrigjojnë ankesat e tyre në

rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2, të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'u refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

III.1.8. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues "NG STRUCTURES" SHPK, duke e konstatuar atë në mungesë të elementeve formale, dhe duke kryer paraprakisht procedurën e përcaktuar në pikën 3, të nenit 111, të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*". Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, **si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës**, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni thekson, se autoriteti kontraktor me të drejtë ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues "NG STRUCTURES" SHPK, me çdo mjet të mundshëm, për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet formale të ankesës në mënyrë që ky i fundit të mund të korrigjonte mangësitë e konstatuara brenda 2 ditëve nga vënia në dijeni. Në datën 29.10.2025 më anë të kërkesës nëpërmjet postës elektronike, ka njoftuar operatorin ekonomik "NG STRUCTURES" SHPK nëpërmjet postës elektronike të përcaktuar në formularin e ankesës së vëtë operatorit ekonomik për korrigjimin e të metave lidhur me ankesën me nr. A/2025/6011, datë 24.10.2025 dhe me nr. 3027 prot, datë 27.10.2025 për të marrë masat për kryerjen e veprimeve procedurale nga ana e operatorit ekonomik konkretisht kryerjen e pagesës së tarifës përkatëse për ankesën e sipërcituar. Nga njoftimi i bërë si më sipërcituar nëpërmjet adresës elektronike operatorit ekonomik "NG STRUCTURES" SHPK nga ky i fundit nuk u bë asnjë veprim procedural brenda 2 ditëve si **afatit përfundimtar për plotësimin e të metave të ankesës**.

III.1.9. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk është privuar nga mundësia që i jep ligji për të korrigjuar një prej elementeve formale të domosdoshme. Fakti që nuk ka korrigjuar të metat e ankesës brenda afatit, si në rastin konkret pagimin e tarifës së ankesës, nuk e ka privuar këtë të fundit nga një prej të drejtave më themelore në

procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit. Referuar arsyetimit, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës, si dhe ka refuzuar ndreqjen e të metave sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni gjykon, se ankesa operatorit ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK, nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj bazuar në germen “a” të pikës 2, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kjo ankesë duhet refuzuar.

III.2. Lidhur me pretendimet ankesës nr. A/2025/6005 datë 24.10.2025 të operatorit ankimues “Shendelli” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, me pretendimin konkret se “1. Klasifikimi i gabuar i objektit dhe tipit të kontratës që prokurohet Referuar preventivit të punimeve, pjesa dërrmuese e zerave (përfshirë gërmimet, betonimet, punimet e hekurit, montimet mekanike dhe elektrike, rikonstruksionin e strukturave dhe sistemit e jashtëm) janë punime ndertimore dhe montimi, që përbejnë mbi 70% të vlerës totale të kontratës. Në këtë kuader, objekti ka natyrë ndertimore, pasi përfshin rikonstruksion të plote të një veprë ndertimore në Hidrovori i Qytetit të Vlorës, ndërsa mallrat (pompat, panelet, etj.) janë elemente ndihmës, jo qellimi kryesor. Klasifikimi i procedurës si “Furnizim Mallrash” është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit për kontratat e punimeve, të cilat përfshijnë Ëdo rikonstruksion ose ndërhyrje ndertimore që kërkon punime mekanike dhe elektrike për realizimin e veprës.... Pra, vlerësimi i bërë nga AK është faktikisht i gabuar dhe nuk reflekton ndarjen reale të kostove; në praktikë, pjesa ndertimore dhe montuese përben mbi 70% të volumit real të kontratës. Për pasojë, klasifikimi si “Mallra” është i paarsyeshëm dhe në kundërshtim me natyrën teknike e funksionale të objektit, që është “Rikonstruksion i një veprë ndertimore ekzistuese”. Gjithashtu nga kërkesat në dëst shohim që kërkohej drejtues Teknik, staf I specializuar dhe mjete, të cilat janë të domosdoshme dhe kryesisht për të realizuar punime ndertimore dhe jo furnizimi. Kërkojmë ndryshimin e llojit të procedurës nga “Mallra” në “Punë”.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në “NJOFTIMIN E KONTRATËS”, Seksioni 2 “Objekti i Kontratës: Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendosije), pika 2.3 “Lloji i Kontratës” të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

2.3. Lloji i “Kontratës Publike për furnizim”

III.2.2. Në Shtojcën 7 “FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT”, të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar se Sasia e mallit që kërkohet, sipas materialit bashkëlidhur në PDF, e konkretisht si më poshtë vijon:

PREVENTIV

Objekti: "Rehabilitimi i Hidrovorit te qytetit Vlore"

Nr.	Anal	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia
I. Punime ndertimi				
1. Punime prishje, germimi & prita e bllokimit te ujit				
1	3.98/a	Germim dheu me eksk. zingjir 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, k. III, me shk ne mjet (per dherat e prites)	m3	760
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	760
3	3.47/1a	Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te bute	m3	760
4	3.99/b	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~1m, k. III, shkarkim ne mjet (heqja e prites)	m3	760
5	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	760
6	3.595	Heqje uji me elektropompa 40KW	op	720
7	3.17/a	Germime dheu ne seksion te lire me krahe,ne toke te bute,kateg.I-II, trans.karro dore deri 10 m	m3	110
8	3.405/1	Prishje struktura prej betoni (mure betoni & shtresat e ceduara)	m3	18
9	3.99/b	Germim dheu me eksk. zingjir 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~1m, k.	m3	216
10	3.99/b	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~1m, k. III, shkarkim ne mjet (para pllakes)	m3	144
11	3.99/b	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~1m, k. III, shkarkim ne mjet (muret anesore)	m3	222
12	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km (germimet e mbeturinat)	m3	710
Shuma 1				
2. Punime betoni e hekuri shtesa e pilave e portave				
1	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	354
2	3.240	Struktura monolite betoni C 12/15 (nenshtrese pllaka themelit e mureve anesore)	m3	11,3
3	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (pllaken e shteses)	m3	43,2
4	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (shtesa e pilave)	m3	81,4
5	3.288	F+v. hekur betoni zakonshem Ø >12mm (pllaka, pilat & muret kufizues)	ton	8,4
6	3.245/1	Struktura te holla monolite betoni C 25/30 (soletat e sherbimit)	m3	16,4
7	3.287	F+v. Hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm (soletat e sherbimit)	ton	0,45
8	3.288	F+v. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm (soletat e sherbimit)	ton	1,87
9	4,3	Konstruksione metalike te thjeshta (inkastrimi i portave)	ton	3,84
10	4,3	Konstruksione metalike te thjeshta (portat)	ton	5
11	4,3	Konstruksione metalike te thjeshta (zgarave prites)	ton	6,17
12	4,3	Konstruksione metalike te thjeshta (zgarat e sherbimit mbi soletat)	ton	1,25
13	4,112	Bojatisje mbi metal 1m2, me nje dore minio e dy duar boje vaji, konstruksione me profile	m2	688
14	An.1	F+v. Parmake metalike	ml	150
15	3.25/c	Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e forte (tubot e dergimit)	m3	44
16	3.405/1	Prishje struktura prej beton (muri i vaskes se daljes)	m3	8
17	3.183/c	Shtrese zhavor lumi t=20cm	m2	12
18	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (blloku i mbeshtetjes se tubove te dergimit te pompave)	m3	7,35
19	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (muri i vaskes se daljes)	m3	6
20	3.288	F+v. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm (qafore fiksimit tubi dergimit)	ton	0,28
21	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve (kanali i tubove)	m3	34
22	3.158/5a	Transport dheu i germuar 5km	m3	43
23	4,3	Konstruksione metalike te thjeshta (platforma montimi flauvalvolave)	ton	0,15
23	4,3	Konstruksione metalike te thjeshta (platforma montimi flauvalvolave)	ton	0,15
24	4,112	Bojatisje mbi metal 1m2, me nje dore minio e dy duar boje vaji, konstruksione me profile	m2	15
25	An.36	F+v. gomina per portat e hyrjes	ml	109
Shuma 2				
3. Punime per montimin e pompave				
3.1. Punime per vendosjen e 1 pompe				
1	An.4	Cmontim e konservim i pompave egz. Ganz Mavaga kkW-440	cope	1
2	2.568	Heqje konstruksione metalike (cmontim i tubacioni te pompes egz. Tip Ganz Mavaga kkW-440)	ton	4,6
3	2.568	Heqje konstruksione metalike (cmontim i tubacionit te dergimit)	ton	5,9
4	An. 5	Cmontim e konservim i paneleve elektrike te pompave egzistuese Ganz Mavaga kkW-1400	cope	1
5	3.409	Izolimi i ujrave ne fuga pas betonimit (hidroizolim me materiale speciale te fugave qe rrjedhin ne dhoma e pompes)	ml	86
6	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (me aditiv antisulfat per riparimet e betoneve e shtresave - hyrja e vaskave hyrese e ne dhomat e punes).	m3	2
7	4,1	F.V Konstruksione metalike te perbera (montimin e pompes zhytese KPL.1600.400.14.T.50.19.L.40)	ton	1,35
8	4,104	F+v. Tuba celiku te kat.I-II ne linja teknologjike kat.I-II >Ø90 (tubi i montimit te pompes Dn-1600/14mm, L=7.6 ml)	ton	4,12
9	4,104	F+v. Tuba celiku te kat.I-II ne linja teknologjike kat.I-II >Ø90 (tubi i dergimit te pompes Dj-142/10mm, L=14 ml)	ton	4,9

10	An.6	F+v. filanxe 265/165 cm, t=24 mm	cope	1
11	An.7	F+v. filanxe 200/160, t=24 mm	cope	6
12	An.8	F+v. filanxa Dn182/142; t=20	cope	12
13	4,3	Konstruksione metalike te thjeshta (shkallet e dhomes pompes (2cope/dhome)	ton	0,3
14	4,109	Bojatisje mbi metal 1m2, pulverizim me alumin	m2	235
15	An.9	Vendosja Unaze e sediles mbeshtese te pompes tip KPL.1600.400.14.T.50.19.L.40 me Q=5500 l/sec dhe H=5.5m	cope	1
16	An.10	Montim -Elek/pompa zhytесе tip -KPL.1600.400.14.T.50.19.L.40 me Q=5500 l/sec dhe H=5.5m	cope	1
17	op	Vendosje Zinxhire me L=10m per ngritje pompe 8000kg	op	2
18	An.11	Sistemi i lidhjes se kablove te fuqise dhesensoreve te pompes perfshi aksesoret fiksues te kablove (litar celiku, lidhes plastike, kapse gomine ,spinot celiku $\Phi=90\text{mm}$ L=1650mm qe mban varur zinxhirin e pompes dhe tirantet per fksimin e kavos.	cope	1
19	An.12	Montim Moduli hyres /dales IO113 i sensoreve te pompes - KPL.1600.400.14.T.50.19.L.40	cope	1
20	An.13	F+v. sensori i modulit SM113 per kontrolin e parametrave te elektropompes.	cope	1
21	An.3	F+v. flauvalvul me kapak me perplasje ne fund te tubit.	cope	1
22	An.14	F+v. kutia e daljes se kablove te fuqise dhe te sensoreve nga tubi kollon per tu lidhur me panelin e leshimit.	cope	1
23	4.125/2	F+v. Ventil celiku me filanxa , Pn25 bar, $\phi 50$ (ajruesi i tubacionit te kollones se pompes)	cope	1
24	An.15	Prova pa dhe me ngarkese e pompes zhytесе	op	72
		Shuma 1 pompe		
		2 pompa		2
		Shuma 3		
		4. Punime montimi paneleve elektrike dhe vinc urave		

1	An.16	Montimi i Paneleve T.U 0.4kV per leshimin automatik/Manual te elek/pompave zhytесе dhe aksiale me Driver VFD dhe me SoftStarter me 10 seksione; 3 PTU hyrje transformatori dhe celes seksionimi+4 PLM te pompave +1 Panel permisimi cos Φ dhe 1 panel nevojat vetijake te stacionit.	cope	1
2	An.17	Vendosje elektrovinci 10 Telfer me 6 levizje me inverter me shpejtesi te limituar, lart -poshte, majtas - djathtas, para - mbrapa.	cope	1
3	An.18	Vendosje vinci cchap - 1 ton	komple	1
4	An.19	F+v. Ilmarine e riguar per gropat e pomave ne siperfaqe dhe kanalet e kablove TU	m2	17,7
5	An.1	F+v. parrake shkalle & platforma ne ndertesën e hidrovorit	ml	12,6
		Shuma 4		
		5. Punime ndertesës e hidrovorit dhe kabines elektrike		
1	2.426	Prishje mur tulle pa pastrim (dhoma e celave & hapje dritare te reja)	m3	4
2	2.310	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 (meremetime ne suvatimet ekzistuese e shpatulla dritare)	m2	24
3	2.375/2a	Dritare d/al ne kabinen elektrike dyfish xham	m2	8,7
4	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a. (kabina elektrike k. I & dalja ne tarace)	m2	7,4
5	2.266/1	Shtrese me plaka granili me boje, 30x30cm	m2	140
6	4,3	Konstruksione metalike te thjeshta (platforma e vendosjes Celave TN20 kv)	ton	0,2
7	2.404	Boje hidroplastike (lerje hidrovorit brenda e jashte)	m2	1845
		Shuma 5		
		6. Punime sistemimi te jashtme		
		6.1. Sheshi para hidrovorit (S=200 m2)		
1	3.95/b	Germin per sheshin e nivelim tm=20 cm sheshi para hidrovorit	m3	75
2	3.183/c	Shtrese zhavor lumi t=20cm	m2	250
3	3.243	Beton C16/20, shtrese sheshi para ndertesës se hidrovorit	m3	50
4	3.288	F+v. Hekur betoni i zakonshem $\phi 6 \sim 10\text{mm}$ (zgara 15*15cm sheshi para nderte	ton	1,54
		Shuma 6.1		
		6.2 Muret kufuzues & mbajtes majtas dhe djathtas hidrovorit		
1	3.405/1	Prishje struktura prej betoni (muret e shkallet ekz. majtas)	m3	22
2	3.405/1	Prishje struktura prej betoni (muret e shkallet ekz. djathtas)	m3	6
3	3.98/b	Germim dheu eksk. zingjir 0.25 m ³ , kanale gjeresi> 2 m, toke zak. k. III, me shkarkim ne mjet (muret kufuzues&mbajtes, shkallet majtas)	m3	356
4	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve (gropat ekz. te mbledhjes se mbeturanave)	m3	88
5	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve (shkallet majtas)	m3	71
6	3.240	Struktura monolite betoni C 12/15 (nenshtrese muri te shkallet majtas)	m3	2,5
7	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (muri anesor majtas & shkallet)	m3	97,15
8	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (riparime mur anesor e shkallet djathtas, kabina elektrike)	m3	9,3
9	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (sheshi kuota -0.5 majtas t=30 cm)	m3	62,1
10	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (sheshi kuota -0.5 djathtas t=30 cm)	m3	17,1
11	3.288	F+v. Hekur betoni i zakonshem $\phi > 12\text{mm}$	ton	1,25
12	3.616	F+v. Bordura betoni 12x25cm (trotuar rreth ndertesës)	ml	70

13	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (trotuar)	m3	4
14	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm (sheshi majtas vaskes daljes)	m2	336
15	3.964	F+v. mbjellje peme dekorative me D=10 cm (cdo 6m)	cope	30
16	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	174
Shuma 6.2				
6.3 Rrethimi i jashtem				
1	2.50	Germim e mbushje dheu me krah kat III per themele, h=1.5m	m3	34
2	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20	m3	44,8
3	An.2	Rrjete tel xingato te veshur plastike jeshile H=1.0 m	m2	167
4	3.245/1	Struktura te holla monolite betoni C 25/30 (kolloncinat 10x10cm)	m3	1,38
5	3.287	F+v. hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm (kollonat e rrethimit 10*10 cm)	ton	0,74
6	3.247	Struktura monolite betoni me çakell C 25/30 (kollonat e portave)	m3	3,84
7	3.288	F+v. F+v. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm (kollonat e portave)	ton	0,27
8	4,3	Konstruksione metalike te thjeshta (portat e hyrjes)	ton	0,23
9	4.112	Bojatisje mbi metal 1m2, me nje dore minio e dy duar boje vaji, konstruksione me profile	m2	12
10	An.2	Rrjete kuadrat e veshur jeshile (8*8 cm)	m2	13,6
Shuma 6.3				
6.4 Rruga auto hidrovorit				
1	3.98/b	Germim dheu ekskavator zingjir, 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, k. III, me shkarkim ne mjet	m3	176
2	2.260/1	Shtrese çakelli t=25cm, me cilindrim	m2	100
3	3.207/1	Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	850
4	3.212/b	Shtrese stabilizanti t=10 cm	m2	850
5	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri	m2	700
6	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	700
Shuma 6.4				
Shuma 6 (6.1-6.4)				
SHUMA I (1-6)				
II. Punimet elektrike & Instalimet elektro-mekanike				
1. Cmontim e te pjeseve elektrike te kabines TM/TU 6/0.4kV.				
1	An.21	Cmontim i tranvesave, izolatoreve zbarave, ndaresave TM-6 kv,dy dhomat	cope	2
2	4.03-M	Cmontim i transformatorit me Sn=1000 kVA ,6/0.4 kV	cope	2
3	An.22	Cmontim i kabllove T.U nga transf.- panel leshimi- pompa	ml	264
4	An.23	Cmontim i kabllove TM 6 kV, ndares - trasformatoret	ml	32
Shuma 1				
2. Tokezimi i shtylles Ankerore				
1	4.150/11	F+v. Percjellesa Cu te izoluar me gome, ndricim, ne izolator, sex. 70mm2	ml	19
2	2.496	F+v. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m		3
3	2.490/h	F+v. Kasete plastike KE me 54 modular (vende)	cope	3
4	2.487/b	F+v. Kuti suport pllaket 4 mod	cope	1
5	3.654/1	F+v. tubo korrogato Ø=40mm2	m.l	6
6	An.35	F+v. shkeputes tokezimi.	cope	1
Shuma 2				
3. Montimi i paisjeve te T.M/TU -20/6/0.4 kV ne kabine.				
1	An.24	Vendosje panele TM 20kV (cela- Hyrje linje + dalje linje + Mbrojtje Transformatori)	set	2
2	An.25	Vendosje transformatori fuqie 20/6/0.4, Sn=1250 kVA	cope	2
Shuma 3				
4. Furnizim vendosje ne kanale kabell fuqie TU te panelit te leshimit				
1	An.26	F+v. lidhja e kabllove nje deje Cu -240mm2 -FG7OR 0.6/1kV te transformatori 1250kVA dhe Panelit te Leshimit te elek/pomave 3 faze 3x(8deje x240mm2)/faze + N 1x240mm2+PE1x240mm2 me L=20ml. Tr.Nr-1	ml	520
2	An.26	F+v. lidhja e kabllove nje deje Cu -240mm2 -FG7OR 0.6/1kV te transformatori 1250kVA dhe Panelit te Leshimit te elek/pomave 3 faze 3x(8deje x240mm2)/faze + N 1x240mm2+PE1x240mm2 me L=30ml. Tr.Nr-2	ml	780
3	An.26	F+v. lidhja e kabllove nje deje Cu -240mm2 -FG7OR 0.6/1kV nga Paneli i Leshimit tek elek/pomavet aksiale ekzistuese Ganz 3 faze 3 x240mm2 + N 1x240mm2 per te dy pompat.L=25 m	ml	200
	An. 45	Kabell per furnizimin me energji te vincit cjaq	ml	80
4	1	F+v. kapikorta Cu te kallaisura Ø=240mm2	cope	37
5	2.480/3	F+v. tub termike Ø=240 mm2	ml	3
6	4.142/2.1 5	F+v. Kablo kontrolli Cu te armuar, ne toke, 4x2.5 mm2 (komanden e sondave te nivelit te ujit)	ml	90
7		F+v. Buloneri +dado+rrondele	kg	30
8		Lidhese plastike te medha per shterngimin e kabllove te fuqise	pako	4
Shuma 4				
5. Tokezimi i kabines TM/TU 20/10/0.4kV				
1	4.150/12	F+v. Percjellesa Cu te izoluar me gome, per ndricim, ne izolator, sexion 95mm2	ml	50
2	2.496	F+v. Elektroda profil "L"Fe/Zn 50x50x5mm me aksesoret.	cope	8
3	2.490/h	F+v. kasete kontrolli PVC 30X30X50 cm	cope	8
4	2.487/b	F+v. Kuti PT-5	cope	2

5	An.35	Shkeputes tokezimi	cope	1
6	3.654/1	F+v. Tuba plastmasi ø 80	ml	30
Shuma 5				
6. Mjetet mbrojtëse dhe të sinjalistikës në kabinën T.M/TU.				
1	An.27	Furnizim tapeti elektrik TM - cela 3x1m	m2	3
2	An.27	Furnizim tapeti elektrik TM - ndares 1.5x1m	cope	1.5
3	An.28	Furnizim doreza dielektrike TM	cope	3
4	An.29	Furnizim cizme dielektrike TM	cope	3
5	An.30	Furnizim shtange dielektrike TM-20 Kv	cope	1
6	An.31	Furnizim indikatorë 20 kV TM	cope	1
7	An.32	Furnizim tokezues portativ	cope	1
8	3.614	Pergatitje e vendosje tabela sinjalizimi	cope	22
Shuma 6				
7. Instalimet elektrike të ndërcimit, prizave dhe dedektoreve të timit të godinës së hidrovorit.				
1	2.480/3	F+v. Tub plastmasi Ø 22-26mm	ml	25
2	2.516/1	F+v. Tuba e rakorderi PVC	kg	2
3	2.487	F+v. Kutiderivacioni plastm	cope	6
4	2.487/a	F+v. Kuti suport pllaket 2 mod	cope	11
5	2.485/4	F+v. Çeles 2 polar 220V 10A	cope	5
6	2.485/e	F+v. Priza shuko jashtë murit 2P+T IP=54	cope	5
7	2.485/f	F+v. priza tre fazore 32A 3P+N+T	cope	2
8	2.481/1	F+v. perçjelles PV-500 Ø=1.5mm2	ml	76
9	2.481/2	F+v. perçjelles PV-500 Ø=2.5mm2	ml	76
10	2.481/3	F+v. perçjelles PV-500 Ø=4mm2	ml	75
11	2.461	F+v. Ndricues 2x36w,IP40 - Led	cope	6
12	2.463	F+v. Ndricues projektor me llampe SAP-T 250w	cope	6
13	2.459	F+v. Ndricues 1x60w,IP65 -Led	cope	2
14	4.142/2.15	F+v. Kablo kontrolli Cu të armuar, në toke, 4x2.5 mm2 (projektorët jashtë ndërtesës)	ml	50
15	2.490/f	F.V Kasete plastike KE me 36 modular (vende)	cope	1
16	2.473	F+v. Ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40	cope	3
17	An.37	F+v. automat RCCB 25A 2P -220V IΔ=30mA	cope	2
18	An.37	F+v. automat RCCB 32A 2P -220V IΔ=30mA	cope	4
19	An.38	F+v. automat RCCB 32A 4P -400V IΔ=30mA	cope	2
20	An.39	F+v. automat MCCB 100A 3P-380V, (mbrojtje diferenciale)	cope	1
21	An.40	F+v. automat MCB 2P C-16A	cope	4
22	An.41	F+v. Automat MCB 2P C-32A	cope	3
23	An.42	F+v. Automat MCB 2P C-25A	cope	4
24	An.43	F+v. Automat MCB 4P C-32A	cope	2
Shuma 7				
8. Furnizimi vendosje e sistemit të ndërcimit në katin perdhë të dhomave të punës së pompave				
1	An. 44	F+v. transformatore ules 380/220/24-36V Sn= 550VA	cope	1
2	2.480/3	F+v. Tub plasmasi PVCØ=22-26mm	ml	38
3	2.487/a	F+v. kuti celsa dhe priza J.M IP-65	cope	6
4	2.461	F+v. Ndricues 2x36w,IP40 - Led	cope	6
5	2.481/1	F+v. perçjelles PV-500 Ø=1.5mm2	ml	120
6	2.487/a	F+v. kuti celsa dhe priza J.M	cope	2
7	An.40	F+v. Automat MCB 2P C-16A	cope	1
8	An.37	F+v. Automat RCD 2P IΔ=30mA	cope	1
Shuma 8				
9. Tokezimi i panelit të leshimit të e/pompave dhe nevojave vetijake				
1	4.150/12	F+v. Perçjellesa Cu të izoluar me gome, për ndërcim, në izolator, seksion 95mm2 (konturii i tokezimit)	ml	40
2	2.496	F+v. Elektroda profil "L"Fe/Zn 50x50x5mm me aksesoret.	cope	4
3	2.490/h	F+v. kasete kontrolli PVC 50X50X50 cm	cope	4
4	2.487/b	F+v. Kuti PT-5	cope	1
5	An.35	Shkeputes tokezimi	cope	1
6	3.654/1	F+v. Tubo korrogato Ø-40mm2	ml	15
Shuma 9				
11. Tokezimi i transformatoreve				
1	2.490/h	F+v. kasete kontrolli PVC 50X50X50 cm	cope	8
2	2.496	F+v. Elektroda profil "L"Fe/Zn 50x50x5mm me aksesoret.	cope	8
3	2.480/5	F+v. Tub plastmasi Ø 31-36mm	ml	50
4	4.150/12	F+v. Perçjellesa Cu të izoluar me gome, për ndërcim, në izolator, seksion 95mm2 (konturi i tokezimit)	ml	50
5	4.167	F+v. Tokezime e mbrojtje atmosferike në objekt me hekur shirit	ml	50
Shuma 11				
12. Sistemi i mbrojtjes atmosferike				
1	4.167	F+v. Tokezime e mbrojtje atmosferike në objekt me hekur shirit	ml	200
2	4.150/12	F+v. Perçjellesa Cu të izoluar me gome, për ndërcim, në izolator, seksion 95mm2	ml	60
3	2.490/h	F+v. Kasete plastike KE me 54 modular (vende)	cope	8
4	An.33	F+v. tulla betoni, kompletuar me suporta mbajtes shirit tokezimi 30x3 mm, SCTP1	cope	35
5	2.496	F+v. Elektroda profil "L"Fe/Zn 50x50x5mm me aksesoret.	cope	6
6	An.34	F+v. shufra rufepritesi, H=1.5m të xinguar perfshi morsetat shtrenquese	cope	13
7	An.35	Shkeputes tokezimi	cope	4
8	2.487/b	Kuti hermetike PT-5	cope	4
9	2.480/5	F+v. Tub plastmasi Ø 31-36mm	ml	60

		Shuma 12		
		SHUMA II		
		SHUMA I+II		
		5 % fond rezerve		
		Shuma		
		20% TVSH		
		Totali I (Ndertim montime)		
		II. Furnizim makineri -pajse		
1		Cela hyrje + dalje SF6 me mikroprocesore TM20kV per transformoret 1250kVA	cope	2
2		Cela mbrojtje TM 20 kV per transformoret 1250kVA	cope	2
3		Cele matje me tarfo ryme + tensioni me mikroprocesor TM 20 kV per transformoret 1250kVA	cope	1
5		Transformatore fuqie me vaj 20/6 /0.4 Kv- 1250kVA (binjake)	cope	2
6		Elek/pompa zhytse tip KPLKPL.1600.400.14.T.50.19.L.40 komplet sipas percaktimit ne projekt. Q=5.5 m3/sec; H=5.5m; Fuqia 400kW, Numri i Poleve të motorit: 14 pole; Shpejtesia e rrotullimeve: 410 rpm; Tensioni: 3 x 400 V; Rryma Maksimale: 804 A; Mënyra e Startimit: Direct On Line (DOL); Mbrojtje e motorit: PTO/PT100; Pompa e pajisur me sensor në rast penetrimi të lageshtisë; Pompa e kompletuar me kabull fuqie dhe sinjali të sensorëve; Tipi i kabullit të fuqisë: PNCTR-S; Gjatësia e kabullit: 10 ml ; Hermetizimi sipas (IEC 34-5): IP68; Izolimi sipas (IEC 85): F; Materiali i Pompës: Gizë sipas EN 1561 EN-GJL-250; Materiali i Helikës: Celik Inox sipas EN 1.4308; Tipi i Helikës: Propeller me 4 fletë/tehe me kënd 19°; Diametri i helikës: 1150 mm; Ne kompletin e pompes (parashikuar ne cmimin e saj) jane pjese perberese: Unazë mbajtëse për fiksimin e pompës në tubin e pompes; Zinxhir ankorimi për uljen/ngritjen e pompës prej Celiku Inox Sistemi i mbështetjes dhe fiksimit të kabullit të pompës. Moduli i Sensorit të pompës; Tub i kollonës për vendosjen e pompës DN1600/14 me gjatësia 5 ml.	cope	2
7		Panele T.U 0 .4kV per lëshimin Automatik/Manual te elek/pompave 2 pompave zhytse te reja dhe 2 pompat aksiale Tip Ganz Mavaga ekzistuese, me Driver VFD dhe me Softe Starter me 10 seksione sipa projektit; 3 PTU hyrje transformatori dhe celes seksionimi+4 PLM te pompave +2 Panele permisimi cos Φ dhe 1 panel nevojat vetijake te stacionit (shiko projekt & specifikime teknike)	komple	1
8		Elektrotal 10 ton me inverter, shpejtesi te limituar me 6 drejtime levizjeje	cope	1
9		Vinc kulle, Lkrahut - 26 m, Aftesia mbajtëse ne fund te krahut P=2.0 ton, lartesia e kullës H=14 m	cope	1
10		Kondicioner 24 btu per dhomen e celave TM20kv	cope	2
11		Aspiratore 300 m3/ore	cope	2
12		Termostat dhome	cope	1
13		Grile me filter inkaso ne deren e hyrjes	cope	1
		TOTALI II (Makineri e pisje)		
		TOTALI		

III.2.3. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.4. Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar është përcaktuar përgjegjësia e autoritetit kontraktor, si më poshtë:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.2.5. Në nenin 4 të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, “Përkufizime” pika 19. *“Kontrata publike për punë” janë kontratat publike që kanë si objekt të tyre: a) kryerjen ose projektimin dhe kryerjen e punëve në lidhje me një ose më tepër aktivitete ndërtimore, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik; b) realizimin ose projektimin dhe realizimin e një pune; c) realizimin me anë të çdo mjeti të një pune, që përkon me kërkesat e specifikuara nga autoriteti kontraktor që ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektin e punës.*

Ndërsa pika 18. *“Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë publike furnizimi mund të përfshijë në mënyrë dytësore edhe vendosjen edhe instalimin.*

III.2.6. Në nenin 5 “Kontratat e përziera” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se : *“1. Kontratat, që kanë si objekt të tyre dy ose më shumë lloje prokurimi për punë, shërbime ose furnizime, jepen në përputhje me dispozitat e zbatueshme, sipas llojit të prokurimit që karakterizon **objektin kryesor të kontratës në fjalë**. 2. Në rastin e kontratave të përziera, që përbëhen pjesërisht nga shërbimet e parashikuara në kreun XII të këtij ligji dhe nga shërbime të tjera, ose kontrata të përziera, që përbëhen pjesërisht nga shërbimet dhe pjesërisht nga furnizimet, **objekti kryesor përcaktohet në përputhje me vlerën më të lartë të parashikuar për shërbimet ose furnizimet përkatëse.**”*

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për përzgjedhjen e fituesit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vlerësimit dhe krahasimit të ofertave. Vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.8. Referuar sa më sipër, nisur nga pretendimet e ankimuesit “Referuar preventivit të punimeve, pjesa dërrmuese e zerave (përfshirë germimet, betonimet, punimet e hekurit, montimet mekanike dhe elektrike, rikonstruksionin e strukturave dhe sistemit e jashtme) janë punime ndertimore dhe montimi, që përbejnë mbi 70% të vlerës totale të kontratës. Në këtë kuadër, objekti ka natyrë ndertimore, pasi përfshin rikonstruksion të plote të një veprë ndertimore në Hidrovori të Qytetit të Vlores, ndërsa mallrat (pompat, panelet, etj.) janë elemente ndihmes, jo qëllimi kryesor”, KPP nga verifikimi i DST dhe preventivi për këtë procedurë, konstaton se AK ka përdorur DST për mallra për arsye se dhe në preventiv zërat për punë ndertimore kanë një peshë specifike me të vogël në vlerën e kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se përcaktimi i autoritetit kontraktor në “*NJOFTIMIN E KONTRATËS*”, Seksioni 2 “*Objekti i Kontratës: Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendorsje)*”, pika 2.3 “*Lloji i Kontratës*” të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, si “*Kontratë Publike për furnizim*” e cila është haptazi në përputhje me dispozitat e legjislationit në fuqi, për prokurimin publik, konkretisht me nenin 5 “*Kontratat e përziera*” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se **objekti kryesor përcaktohet në përputhje me vlerën më të lartë të parashikuar për shërbimet ose furnizimet përkatëse**” dhe ndodhur në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor me të drejtë ka përcaktuar llojin e procedurës së prokurimit në përpjestim me vlerën më të lartë që nga verifikimi i preventivit i përkasin mallrave, furnizimit dhe vendosjes.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” SHPK mbi kriteret e përcaktuar në dokumentet e tenderit me arsyetimin se “*Vendosja e kriterëve të pajustificuara për personel teknik Në dokumentet e tenderit janë kërkuar në mënyrë të pazakonte për një kontratë “mallrash”: nente (9) inxhinierë të profilizuar në fusha të ndryshme, njëzet e një (21) specialiste dhe staf profesional, dyzet (40) punëtorë të*

kualifikuar, shoqeruar me nje liste te gjere mjetesh dhe pajisjesh ndertimore. Ky volum kerkesash tregon qarte se objekti nuk eshte furnizim mallrash, por punime ndertimore. AK ne pergjigjen e kerkeses per sqarim eshte shprehur se “numri i kerkuar i punonjesve dhe stafit teknik eshte percaktuar ne baze te grafikut te punimeve, zberthimit te zerave te preventivit dhe afatit te punimeve, duke rezultuar ne total 31,723 ore pune qe justifikojne kerkesen per 40 punonjes, perfshire stafin teknik”. Por kjo nuk qendron sepse, ky argument bie ndesh me vete klasifikimin e procedures si efurnizim mallrash. Nje kontrate qe parashikon grafik punimesh, ore pune, fuqi punetore, staf teknik te profilizuar dhe mjete ndertimi, nuk mund te konsiderohet kontrate per furnizim, por kontrate per punime ne kuptimin e ligjit. Per me teper, vendosja e nje numri te fiksuar dhe te larte punonjesish (40) nuk eshte mbeshetur ne asnje analize te detajuar proporcionaliteti midis volumit te punimeve dhe afatit kohor. Nje kerkese e tille shkon pertej qellimit te ligjit, duke kufizuar pjesemarrjen dhe krijuar barre te panevojshme mbi operatoret ekonomike.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.7 , të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

“Shtojca 7
[...]

2.3.7 Një punësim minimalisht prej **40 (dyzetë)** punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi **per 3 muajt e fundit** te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3 muajt e fundit** te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per **3 muajt e fundit** te deklaruar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, shprehimisht thuhet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e

mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.3.5. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e kriterit të kualifikimit pika *“2.3.7 Një punësim minimalisht prej 40 (dyzetë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave”*, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje, informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 16406 /7 prot., datë 30.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 3021/1 prot., datë 31.10.2025, Komisioni konstaton se, në lidhje me pretendimin e parë se *“ky volum kerkesash tregon qarte se objekti nuk eshte furnizim mallrash, por punime ndertimore”* për sa kohë kjo kërkesë është shqyrtuar dhe argumentuar në pikën III.2.8 të këtij vendim të mos ripërsëritet në riargumentimin e saj.

Lidhur me pretendimin e dytë se *“vendosja e nje numri te fiksuar dhe te larte punonjesish (40) nuk eshte mbeshtetur ne asnje analize te detajuar proporcionaliteti midis volumit te punimeve dhe afatit kohor”* për numrin e punonjësve të kërkuar, nga përlllogaritja e tabelës së fuqisë punëtore të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor, rezulton se duhet një numër prej 40 në total duke cilësuar 16 punonjës staf teknik të profilit të kualifikimit (Hidraulik, Elektricit, Mekanik, Hekurkthyes, Eskavatorist, Saldator me Tig, Saldator, Murator/Suvatues, Bojaxhi, Teknik të mesëm ndërtimi, Teknik/Specialist të inxhinierisë elektronike), 6 inxhinierë (të profileve ndërtim Strukturist, hidroteknik, topograf/gjeodet/markshajder, elektrik, mekanik, mjedisi) dhe 8 (tetë) punëtorë si staf mbështetës, pra në total 30 punonjës. Ndërsa, në kriterin e kualifikimit janë kërkuar të paktën 40 punonjës. Në procesverbalin *“Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”* vendosjen e këtij kriteri autoriteti e ka argumentuar se *“në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve është vendosur bazuar në sasitë e çdo zëri punimesh punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zbërthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve janë gjithsej 31 723 orë pune punëtori +pune makineri, për të cilat nevojiten 30 punonjës, ku përfshirë dhe stafin teknik nevojiten në total të paktën 40 (dyzetë) punonjës”*. Pra, parë në këto kushte operatori ekonomik ankimues me të drejte ka kërkuar uljen e një numëri të tillë të punonjësve në total, sipas profile të kërkuara në përputhje me përlllogaritjen që ka kryer dhe vetë AK, pasi sipas përlllogaritjes së bazuar në sasitë e çdo zëri punimesh në preventiv dhe afatit të parashikuar të punimeve janë

gjithsej 31 723 orë pune punëtori + pune makineri, për të cilat nevojiten 30 punonjës dhe shtimi i stafit teknik nuk mund të shihet më vete nga sasitë e çdo zëri punimesh në preventiv pa asnjë përlllogaritje duke shkaktuar nje rritje të pajustificuar nga autoriteti kontraktor nga numri total i fuqise punëtore që nevojitet për kryerjen e punimeve i përkon 30 punëtorëve.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” SHPK mbi kriteret e përcaktuar në dokuemntet duke arsyetuar se *“Kerkesa per certifikime elektrike te paarsyetuara dhe te pambeshtetura ligjerisht Ne dokumentet e tenderit jane kerkuar disa profile specifike: Inxhinier Elektrik i certifikuar per monitorimin e gazit dhe vajit te transformatoreve, Inxhinier i certifikuar per kamera termografike, Inxhinier me certifikate per SCADA/PLC, etj. Keto kerkesa jane pa reference ne standarde nderkombetare (IEC/ISO), nuk eshte argumentuar domosdoshmeria e tyre dhe nuk eshte percaktuar asnje trup certifikues i akredituar nga DPA qe mund te leshoje certifikatat perkatese. Gjithashtu, kerkesa qe keta specialiste te jene ne listepagese 3 muajt e fundit eshte diskriminuese dhe pa baze ligjore. K ne pergjigjen e kerkeses per sqarim eshte shprehur se “kerkesat per inxhiniere te certifikuar ne fushen e transformatoreve, termografise dhe sistemeve SCADA/PLC jane vendosur per te garantuar sigurine teknike dhe cilesine e funksionimit te hidrovorit, ne perputhje me nenin 77 te ligjit dhe nenin 40 te VKM nr. 285/2021, duke pranuar edhe certifikime ekuivalente nga trupa te akredituar nderkombetarisht.” Por kjo nuk qendron sepse autoriteti nuk ka bere asnje argumentim konkret qe lidh domosdoshmerine e ketyre certifikimeve me objektin specifik te kontrates, as nuk ka reference ne dokumentet e projektit qe tii kerkoje ato si kusht per zbatim. Standardet IEC qe permend AK jane standarde teknike te pergjithshme, jo detyrim per certifikim personeli, dhe ne asnje nen te ligjit apo te VKM-se nuk parashikohet qe operatoret ekonomike duhet te kene staf te certifikuar nga prodhues specifike per kryerjen e punimeve. Per me teper, ne Shqiperi nuk ekziston asnje trup i akredituar nga DPA qe te leshoje certifikata per ato profile, Áka e ben kriterin praktikisht te pazbatueshem dhe diskriminues. Pranimi “ekuivalent” qe permend AK nuk e korrigjon problemin, pasi nuk percakton menyren e vleresimit te ekuivalences dhe le vend per interpretim subjektiv. Gjithashtu, kerkesa qe personeli te jete ne listepagese per tre muajt e fundit eshte e pajustificuar dhe joproporcionale, pasi qellimi i ligjit eshte garantimi i disponueshmerise, jo i marredhenies kontraktuale te punesimit. Kjo bie ndesh me parimin e barazise dhe lejon vetem subjektet me staf te perhershëm te permbushin kriterin, duke perjashtuar operatore me kontrata sherbimi apo bashkepunime teknike te vlefshme. Ne perfundim, arsyetimi i AK nuk qendron as teknikisht, as ligjerisht, dhe kriteret e certifikimeve mbeten te pajustificuara, te pazbatueshme dhe ne kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe konkurrences efektive. Kerkojme ndryshimin e ketyre kriterëve”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.4.1. Në shtojcën 8 “Formular i i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, parashikon pikën 2.3.6 si më poshtë vijon:

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2.3.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kete si staf mbështetës (me kontrate pune) , ne liste pagese 3 (tre) muajt e fundit si më poshtë:

- 1 (nje) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- 1 (një) punonjes i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (nje) punonjes i pajisur me certifikate specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik, të certifikuar nga prodhuesi / institucione të autorizuar për monitorimin e gazit dhe të vajit të transformatorëve të fuqisë, si dhe në instalimin dhe komisionimin e sistemit në terren pa e shkeputur nga puna.
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik ose Mekatronik i Certifikuar per kamera termografike
- 1 (nje) Inxhinier me Certificate trajnimi per sistemet e leshime automatike (SCADA) dhe per PLC
- 2 (dy) Saldator te Certifikuar sipas standartit EN ISO 9606-1:2017

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet dhe duhet te paraqese:

- Kontratat individuale te punes (të vlefshme).
- Diplomë/Certifikatë

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK. ”

III.4.2. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.4.3. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë,

pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrëthit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.4.5. Në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën “2.3.6. 1 (nje) Inxhinier Elektrik, të certifikuar nga prodhuesi / institucione të autorizuar për monitorimin e gazit dhe të vajit të transformatorëve të fuqisë, si dhe në instalimin dhe komisionimin e sistemit në terren pa e shkeputur nga puna, 1 (nje) Inxhinier Elektrik ose Mekatronik i Certifikuar per kamera termografike, 1 (nje) Inxhinier me Certificate trajnimi per sistemet e leshime automatike (SCADA) dhe per PLC”, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE si edhe informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.16406/7, datë 30.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 3021/1 prot., datë 31.10.2025 konstaton se, nuk është argumentuar në bazë të asnjë zëri punimi apo malli të preventivit që kërkohet në këtë procedurë prokurimi kërkesa për inxhinier të certifikuar për monitorimin e gazit dhe të vajit të transformatorëve të fuqisë apo per kamera termografike dhe per sistemet e leshime automatike (SCADA) dhe per PLC me qëllim që të kërkohet disponimi i dëshmimeve të tilla. Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik për sa dhe argumentuar nga autoriteti kontraktor në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, arrin në përfundimin se inxhinier me certifikime të tilla i shërbejnë në vetëvete procesit të mbikëqyrjes dhe kolaudimit dhe jo të furnizimit dhe vendosjes dhe se vetë profesioni i inxhinierit elektrik përfshinë njohuritë dhe mundësinë profesionale të monitorimit të gazit dhe vajit të transformatorëve të fuqisë në këtë zbatimin e procedurës së rehabilitimit në fjalë. AK nuk ka arritur të argumentoj as nëpërmjet përgjigjes së dhënë nga KSHA për pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se si ndikon në mos realizimin me sukses të kësaj procedure prokurimi dhe as në mënyrë shteruese se për cilat zëra të parashikuar në preventiv i shërbejnë inxhinier më certifikime të tilla, duke mos u mjaftuar me njohuritë dhe mundësinë profesionale të **dëshmis zyrtare sic është kërkuar** (dëshmia zyrtare/Nivel Diplome). Për sa dhe parashtruar më sipër autoriteti kontraktor duhet të argumentojë në mënyrë shteruese me zërat përkatës në preventiv kërkesën në fjalë ose duhet të marrë masa për modifikimin e certifikimeve të kërkuara pasi nuk është justifikuar kërkesa për certifikime të tilla që mund ti shërbejnë zbatimit të kësaj procedurenë kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe konkurrencës efektive.

-Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kërkesa që personeli të jetë në listëpagese për tre muajt e fundit nuk është një periudhë në porporcion me volumin e objektit të kontratës dhe nuk është një periudhë e arsyeshme për të vërtetuar se operatorët ekonomikë ofertues zotërojnë kapacitet teknik lidhur me disponimin e fuqisë punëtore të nevojshme për periudhën e fundit nga data e shpalljes së procedurës së prokurimit, për të realizuar zërat e punimeve objekt prokurimi, Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimesit, Komisioni gjykon, se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik lidhur me figurimin në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, është një kërkesë e ekzagjeruar në këtë procedurë prokurimi për sa i përket periudhës së kërkuar. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë për shkaqe nga më të ndryshmet, janë të detyruar që të bëjnë ndryshime në stafin e tyre, çka cdo të thotë që kjo nuk është një e dhënë statike e pandryshueshme në kohë. Ndryshueshmëria e stafit të operatorëve ekonomikë lidhet me

praktikën e brendshme të tyre dhe nuk ndikon aspak në tregues të performancës, që duhet t'i shërbejë autoritetit kontraktor si garanci në kriteret kualifikuese. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë, që punonjësit për kryerjen e shërbimit të figurojnë në listëpagesat e sigurimeve shoqërore apo vërtetim nga administrata tatimore, për periudhën 3 muajt e fundit pasi operatorët ekonomike në varësi të nevojave të tyre kanë të drejtë të shtojnë apo reduktojnë staf në periudha të caktuara kohore. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesa në fjalë të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar. Në rastin konkret referuar objektit të prokurimit, përmasave të kontratës, zërave të preventivit si dhe kohëzgjatjes së punimeve, KPP gjykon se autoriteti kontraktor në respekt të parimit të proporcionalitetit duhet të ndryshojë periudhën e kërkuar pasi për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që në drejtim të plotësimit të kapacitetit teknik profesional, operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave me anë të dokumentacionit konkret të lëshuar nga organet kompetente të provojnë, se disponojnë një numër të caktuar të punonjësve dhe gjithashtu punonjësit aktualë të jenë të siguruar, por jo të kushtëzojë operatorët ekonomikë që të vërtetojnë se disponojnë një numër të tillë punonjësish për periudhën 3 muajt e fundit. Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit duke ndryshuar kriterin për periudhën kohore të kërimit të vërtetimit të numrit të punonjësve dhe listëpagesave të tyre.

Përsa më sipër, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” SHPK mbi kriterin e përcaktuar në dokuemntet e tenderit konkretisht për piken 2.3.6 “Kërkesa të pajustificuara për saldatore dhe certifikime teknike të pamundura në Shqipëri Ne dokumente është kërkuar: “Saldator me TIG” dhe “2 saldatore të certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1:2017”. Sipas verifikimit në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA), në Shqipëri nuk ekziston asnjë trup certifikues i akredituar për këtë standard. Prandaj, kërkesa është teknikisht e pambeshtetë dhe ligjrisht e pazbatueshme. AK në përgjigjen e kërkesës për sqarim është shprehur se “procesi TIG është teknikisht i domosdoshëm për çilesi të lartë saldimi në Çelik karbon dhe inox, ndërsa kërkesa për dy saldatore të certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1:2017 është standard evropian për kualifikimin e saldatoreve dhe pranohet Cdo certifikate ekuivalente nga trupa të akredituar ndërkombëtarisht, ndaj kriteri është i ligjshëm dhe nuk hiqet.” Por kjo nuk qëndron sepse, edhe pse objekti parashikon saldime, këto janë punime dytesore dhe me volum të kufizuar, që nuk e justifikojnë vendosjen e një kriteri kaq specifik dhe kufizues për certifikim ndërkombëtar të saldatoreve. Ligji nr. 162/2020 kërkon që kriteret e aftësisë teknike të jenë proporcionale me natyrën, vlerën dhe kompleksitetin e objektit, ndërsa në këtë rast kërkesa për certifikim sipas EN ISO 9606-

1:2017 është e tepruar për nivelin e punimeve të parashikuara. Për më tepër, në Shqipëri nuk ekziston trup i akredituar nga DPA që të leshojë certifikata për këtë standard, Cka e bën kriterin vështirësisht të zbatueshëm dhe në praktikë përjashtues për pjesën më të madhe të operatorëve vendas. Pranimi “ekuivalent” që përmend AK nuk e zgjidh problemin, sepse nuk përcakton mekanizmin e vlerësimit të ekuivalencës dhe le hap për subjektivizëm në interpretim gjatë vlerësimit të ofertave. Në përfundim, edhe pse procesi përfshin saldime, kërkesa për dy saldatorë të certifikuar sipas EN ISO 9606-1:2017 është joproporcionale, e pambështetur në analiza teknike dhe në kundërshtim me parimin e konkurrencës së barabartë, pasi vendos barrierë të panevojshme për pjesëmarrjen efektive të operatorëve ekonomikë.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 8 “formular i i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, parashikon pikat 2.3.5, 2.3.6. si më poshtë vijon:

[...] “Shtojca 8

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë.”, si dhe të të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

Profesioni/Kualifikimi	Numri i të punësuarve
1. Saldator me Tig	2
2. Saldator	1

2.3.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë si staf mbështetës (me kontratë punë) , në listë pagese 3 (tre) muajt e fundit si më poshtë:

....

- **2 (dy) Saldator të Certifikuar sipas standartit EN ISO 9606-1:201.**”

III.5.2. Në procesverbalin “Për Argumentimin Dhe Miratimin E Specifikimeve Teknike Dhe Kriterëve Për Kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

“Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.”

III.5.3. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.5.4. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet

e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.5.6. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e kriterit të kualifikimit pika 2.3.5 dhe 2.3.6 e DT për -2 (dy) Saldator te Certifikuar sipas standartit EN ISO 9606-1:2017, dhe -2 saldator me TIG, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje, informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor me anë të shkresës 16406/7 datë 30.10.2025 dhe protokolluar me tonën me nr. 3021/1 prot., datë 31.10.2025, Komisioni konstaton se, në lidhje me pretendimin për 2 (dy) Saldator te Certifikuar sipas standartit EN ISO 9606-1:2017, risjellim në vëmendje se standartit ISO (International Organization for Standardization) është sistem menaxhimi i kompanive, produkteve dhe proceseve dhe jo për persona të veçantë, autoriteti kontraktor në përgjigjen e sipërcituar ka sqaruar kërkesën në mënyrë teknike dhe shteruese duke arsyetuar se “2 saldatorë të certifikuar EN ISO 9606-1:2017 që është standard european për kualifikimin e saldatorëve në çelik. Pranohet çdo certifikatë ekuivalente e lëshuar nga trupa të akredituar në rrjetin Provat NDT në saldime me UT sipas ISO 17640 dhe nivele pranimi ISO 11666 janë praktikë e zakonshme për integritet strukturor. Pse EN ISO 9606-1:2017: Ky është standardi european i kualifikimit të saldatorëve për saldime me shkrirje në çelika. Kërkesa për 2 saldatorë të certifikuar siguron integritet në nyjet kritike (lidhje tubacionesh, struktura mbajtëse, suportet e pajisjeve).” Nuk ka trup të akredituar në Shqipëri” nuk është argument ligjor: Edhe nëse sot një trup vendas nuk mbulon konkretisht 9606-1, certifikatat e lëshuara nga trupa të akredituar në vende të BE/EEA njihen përmes EA-MLA. DPA është EA-MLA signatory dhe njohja e ndërsjellë është e sanksionuar. Për më tepër, certifikimi i personelit kryhet sipas ISO/IEC 17024 dhe NDT sipas ISO 9712 kur aplikohet. Kërkesat për TIG dhe EN ISO 9606-1 janë plotësisht të mbështetura nga standardet europiane dhe mekanizmat e akreditimit”. Nga sa parashtruar edhe nga autoriteti kontraktor por duke u ndaluar akoma më tej te standardi i kërkuar EN ISO 9606-1:2017 vlen të theksohet se është një standardi i cili mbulon proceset e saldimit (TIG, MIG, MAG, MMA...etj) prandaj autoriteti kontraktor duhet të unfikojë kërkesën për saldatorët e sipërcituar duke mos e duplikuar kërkesën në mënyrë të panevojshme me 2 saldator me TIG të mëvetësishëm por duke e komplementuar me formulimin e saktë të saj pasi të dyja kërkesat i referohen procesit të saldimit të celikut. Pra, parë në këto kushte Ak duhet të modifikojë kërkesën për saldator në bazë të profileve të personelit të kualifikuar, duke mos dublikuar profesionet si edhe referuar proceseve të punës që mbon ky profili, për ekzekutimin e kontratës së punës.

Përsa më sipër, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” SHPK qëndron pjesërisht.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” SHPK mbi kriterin e përcaktuar në dokuemntet e tenderit konkretisht për piken 2.3.12 për të cilin ka kërkuar modifikim dhe heqjen e disa prej tyre me konkretisht “Mjete të kerkuara pa baze teknike dhe jashtë objektit të punimeve Emri i mjetit Sasi Njesi Statusi Aparat Argoni 1 cope Ne pronesi ose me qera Ponton (drage lundruese) 1 cope Ne pronesi ose me qera Automjet teknologjik e pajisur me pompe vakumi për thithje llumi . 1 cope Ne pronesi ose me qera Pajisje me ultratinguj për detektimin e defekteve për provat pa shkatërrim të saldimeve për strukturat metalike për trashësi deri në 60mm 1 cope Ne pronesi ose me qera Mates Tokezimi me certifikate kalibrimi 1 cope Ne pronesi ose me qera Multimeter Digital me certifikate kalibrimi 1 cope Ne pronesi ose me qera Dare multimeter me certifikate kalibrimi 1 cope Ne pronesi ose me qera Kamera Termike 1 cope Ne pronesi ose me qera Kalibrues 4-20mA 1 cope Ne pronesi ose me qera Aparate Saldimi me inverter, me certifikate kalibrimi, për saldim me elektrode dhe TIG 410 A 1 cope Ne pronesi ose me qera Aparate Sladimi me inverter, me certifikate kalibrimi, për saldim me elektrode dhe MIG/MAG 500 A 1 cope Ne pronesi ose me qera Ne listen e mjeteve të kerkuara, janë përfshirë pajisje që nuk kanë lidhje funksionale me preventivin, si “Ponton (drage lundruese)”, megjithatë në preventiv nuk parashikohen punime nën ujë apo në thellësi që e justifikojnë përdorimin e saj. Po ashtu, disa mjete të tjera (pajisje ultratinguj, kamera termike, kalibrues 4-20mA, etj.) janë përfshirë pa justifikim teknik. AK në përgjigjen e kërkesës për sqarim është shprehur se “nevoja për mjetin “Drage Lundruese” dhe pajisjet e tjera teknike (pajisje me ultratinguj, mates tokezimi, kamera termike, kalibrator 4-20 mA, etj.) buron nga kushtet e terrenit nën ujë dhe nga domosdoshmëria për sigurimin e cilesisë së punimeve sipas standardeve europiane të ndërtimit dhe instrumentimit elektrik, duke e konsideruar përdorimin e tyre thelbësor për zbatimin e objektit.” Por kjo nuk qëndron sepse, në dokumentacionin teknik dhe preventivin përkatës nuk është përcaktuar asnjë zë për punë që kërkon ndërhyrje në thellësi 4.5 m ose përdorimin e mjeteve lundruese për pastrim apo germim nën ujë. Terreni i përshkruar në projekt është kanal dales me thellësi të kufizuar, për të cilin mund të përdoren mjete tokësore me krah të zgjatur, pa nevojën e pajisjeve të specializuara të tipit “drage lundruese”, që janë karakteristike për basenë të mëdha ujore ose kanale navigimi. Përfshirja e këtij mjeti, së bashku me pajisje laboratorike e matëse që përdoren zakonisht në projekte të kalibrimit industrial, nuk është e justifikuar as nga preventivi, as nga përshkrimi teknik i punimeve. Kjo rrit artificialisht kompleksitetin e objektit dhe kostot, duke krijuar barriera të pajustificuara për operatorët ekonomikë. Ligji nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285/2021 kërkojnë që kriteret teknike të jenë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe koston reale të punimeve. Në këtë rast, AK ka vendosur mjete dhe pajisje që nuk lidhen drejtperdrejt me objektin, përtej nevojës reale të zbatimit. Kërkojmë rishikimin dhe heqjen e mjeteve që nuk lidhen drejtperdrejt me objektin e kontratës.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 8 “Formular i i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, parashikon pikat 2.3.12 si më poshtë vijon:

[...] “Shtojca 8

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2.3.12 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Emri i mjetit	Sasi	Njesi	Statusi
<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 6-10 ton</i>	<i>2</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Ekskavator 0.25 m3</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Tokmak Elektrik</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Betoniere 500 liter</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator thellesie</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Vinc kulle 0.5-1 ton</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Trapano elektrike</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Gazogjen 1 m3/ore</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinç</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Grejder</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Aparat Argoni</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Trapano elektrike</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Pompe suvatimi</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Elektrokompresor</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Fadrome</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Ponton (drage lundruese)</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Makineri per prerje dhe kthim hekuri ndertimi</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>

<i>Rrul hekur-hekur deri 4 ton</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Automjet teknologjik e pajisur me pompe vakumi per thithje llumi .</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Gjenerator / Motogjenerator</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Elektrosaldatrice/Motosaldatrice/Saldatrice/</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Motopompe uji</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Pajisje me ultratinguj për detektimin e defekteve për provat pa shkatërrim të saldimeve për strukturat metalike për trashësi deri në 60mm</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Mates Tokezimi me certifikate kalibrimi</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Multimeter Digital me certifikate kalibrimi</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Dare multimeter me certifikate kalibrimi</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Kamera Termike</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Kalibrues 4-20mA</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Aparate Saldimi me inverter, me certifikate kalibrimi, per saldim me elektrode dhe TIG 410 A</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Aparate Sladimi me inverter, me certifikate kalibrimi, per saldim me elektrode dhe MIG/MAG 500 A</i>	<i>1</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Jelekë</i>	<i>40</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi</i>
<i>Kokore</i>	<i>40</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi</i>
<i>Kuti ndihme e shpejtë</i>	<i>5</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi</i>
<i>Fikëse zjarri të lëvizshme</i>	<i>5</i>	<i>copë</i>	<i>Në pronësi</i>

III.6.2. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.6.3. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.6.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e

mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.6.5. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.12 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 8 “Formulari i Kriterëve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, mbi kërkesën për disponimin e “Ponton (drage lundruese)”, si në vijim: “ne preventiv nuk parashikohen punime nën ujë apo në thellesi që e justifikojnë përdorimin e saj”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në kthim përgjigjen nr. 16406/7 prot, datë 30.10.2025, mbi pretendimin e ankimuesit nuk ka modifikuar këtë kërkesë lidhur me disponimin e pajisjes “Ponton (drage lundruese)”. Lidhur me përcaktimin e nevojës për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e zërave të punimeve objekt prokurimi, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor mbështetur në, projektin e zbatimit të objektit të prokurimit, grafikun e realizimit të punimeve, si dhe referuar zërave të punimeve të përcaktuara në preventiv ka bërë një analizë teknike të këtyre, duke përcaktuar nevojën për disponimin e mjetit apo pajisjeve për realizimin e zërave të punimeve, duke përcaktuar llojin e mjeteve apo pajisjeve për realizimin e zërave të punimeve, si dhe duke përcaktuar sasinë e mjeteve apo pajisjeve për realizimin e zërave të punimeve e kualifikimin profesional të punonjësve të kualifikuar që janë të nevojshëm për realizimin e këtyre punimeve në raport me grafikun e punimeve të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit.

Komisioni referuar pretendimit të ankimuesit, argumentimeve të komisionit të shqyrtimit të ankesës, informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën përcjellëse me nr. 16406/7 prot, datë 30.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 3021/1 prot., datë 31.10.2025, KPP gjykon se, kërkesa për disponimin e mjetit Ponton (drage lundruese) është një kërkesë e argumentuar në mënyrë shteruese me zërat e parashikuar në preventiv dhe me volumin e tyre, pasi referuar informacioneve të dhënë nga AK, ka argumentuar disponimin e një mjeti të tillë.

III.6.6. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kërkimin e autoritetit kontraktor “për pajisjet e tjera teknike (pajisje me ultratinguj, mates tokezimi, kamera termike, kalibrator 4-20 mA.... në dokumentacionin teknik dhe preventivin perkates nuk është përcaktuar asnjë ze pune që kërkon nderhyrje në thellesi 4.5 m ose përdorimin e mjeteve lundruese për pastrim apo germim nën ujë. Terreni i pershkruar në projekt është kanal dales me thellesi të kufizuar, për të cilin mund të përdoren mjete tokësore me krah të

zgjatur, pa nevojën e pajisjeve të specializuara të tipit “drage lundruese”, që janë karakteristike për basene të medha ujore ose kanale navigimi. Përfshirja e këtij mjeti, së bashku me pajisje laboratorike e matëse që përdoren zakonisht në projekte të kalibrimit industrial, nuk është e justifikuar as nga preventivi, as nga përshkrimi teknik i punimeve. Kjo rrit artificialisht kompleksitetin e objektit dhe kostot, duke krijuar barriera të pajustificuara për operatorët ekonomikë”, nga informacioni i dërguar nga AK, dhe nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, përkatësisht grafikut dhe preventivit të punimeve, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, mjetet e mësipërme, nuk janë argumentuar në përputhje me zërat dhe volumet e parashikuara në preventiv për tu kryer (pra duke iu referuar zërave të preventivit, volumeve si edhe terrenit ku do të realizohen punimet). Komisioni konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor, në procesverbalin për argumentimin e kriterëve të vecanta për kualifikim për procedurën objekt ankimi, nuk është argumentuar se përse këto pajisje janë të domosdoshmë në realizimin me sukses të kontratës. Nga ana tjetër, Komisioni konstaton se operatori ekonomik ankimues me argumentat e dhëna në funksion të modifikimit të kriterit 2.3.12 në lidhje me makineritë/pajisjet e kërkuara për realizimin e objektit të kontratës, ka arritur të justifikojë se si modifikimi i këtyre makinerive dhe pajisjeve të kontratës nuk çënon realizimin me sukses të saj dhe se i referohen pajisjeve laboratorike e matëse që përdoren zakonisht në projekte të kalibrimit industrial. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka justifikuar nevojën për disponimin e këtyre pajisjeve. Referuar zërave dhe proceseve të punës së parashikuar në preventiv, Komisioni vlerëson se, *Pajisja me ultratinguj*, përdoret për të kontrolluar cilësinë e punimeve në metale dhe saldime pra përdoret për të dërguar vale ultratingujsh (me frekuencë të lartë) në material përmes një sonde (transduktori) e cila ndihmon në testimin dhe karakteristikat e tjera, gjithashtu dhe pajisjet “*Kamera Termike*” dhe “*Kalibrues 4-20 mA*” kanë përdorim të përgjithshëm në mirëmbajtje, testim dhe verifikim që nuk i shërbejnë qëllimit konkret të punimeve të parashikuara në preventiv në fazën e zbatimit të procedurës së prokurimit në fjalë dhe për më tepër as në përshkrimin e kryerjes së këtyre punimeve në relacionin teknik të “*Rehabilitimit të Hidrovorit të qytetit Vlore*” nuk gjenden punime në kryerjen e këtyre pajisjeve, dhe si rrjedhim për pretendimet e ankimuesit lidhur me pajisjet e sipërcituara autoriteti kontraktor duhet të argumentojë në mënyrë teknike me zërat e punimeve objekt prokurimi për të cilat do të përdoren pajisjet e sipër kërkuara ose në të kundërt të modifikojë kriterin për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Përsa më sipër, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” SHPK qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e*

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NG STRUCTURES” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65227-10-15-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendosje)”, me fond limit 154,687,373.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-65227-10-15-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Hidrovorit të Qytetit të Vlorës (Furnizim Vendosje)”, me fond limit 154,687,373.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shendelli” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyjnë në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fioorent Zguro

